



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1303 / prot.
14

Tiranë, më 26.05 /2020

URDHËR

Nr. 190 /, datë 26.05 .2020

PËR

NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË URDHËRIN NR.190, DATË 19.03.2020 “PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-2019”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të Ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

Në Urdhrin Nr. 190, datë 19.03.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrin pas togfjalëshit “institucioneve arsimore publike dhe jopublike”, hiqet togfjalëshi “dhe çerdheve”.
2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:
“1/1. Lejohet hapja e veprimtarisë së çerdheve dhe kopshteve duke filluar nga data 01.06.2020 e në vijim, në përputhje me protokollin e miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik”.
3. Çdo urdhër që bie në kundërshtim me pikën 2 të këtij urdhri, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

